

Për: Delegatët e Kuvendit të Punës 2025
Nga: Këshilli Mbikqyrës i Federatës së Volejbollit
Lenda: Raport për vitin 2025

Mbështetur në mandatin e Këshillit Mbikëqyrës të Federatës së Volejbollit të Kosovës, të përbërë nga Burim Rahimaj, kryetar, Safete Rifati, anëtare dhe Arian Zeneli, anëtar, Këshilli Mbikëqyrës i FVK-së, në koordinim dhe pas shqyrtimit të dokumenteve dhe materialeve që kanë të bëjnë me punën, ligjshmërinë dhe veprimtarinë materialo-financiare të FVK-së, në vazhdim paraqet këtë:

RAPORT

Këshilli Mbikëqyrës ka shqyrtuar dokumentacionin e nevojshëm, ka realizuar takimet e nevojshme me akterët relevantë, me qëllim të diskutimit të aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës 1 Janar – 31 Dhjetor 2025, si dhe për shqyrtimin e çështjeve tjera që lidhen me aspektet financiare, organizative dhe ligjore të këtij institucioni.

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli Mbikëqyrës ka analizuar Raportin e Punës për vitin 2025, Raportin e Auditorit, Pasqyrat Financiare, si dhe dokumentacionin tjetër relevant që ndërlidhet me funksionimin e përgjithshëm të Federatës së Volejbollit të Kosovës.

Pas analizës së dokumentacionit relevant dhe shqyrtimit të veprimtarisë së përgjithshme të FVK-së për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2025, Këshilli Mbikëqyrës ka ardhur në përfundim se:

1. Këshilli ka vlerësuar se Federata e Volejbollit e Kosovës gjatë vitit 2025 ka ushtruar me përgjegjësi mandatin dhe funksionet e saj statutare, duke dëshmuar nivel të kënaqshëm të efektivitetit në realizimin e objektivave programore, administrative dhe sportive. Ky vlerësim është bazuar në analizën e aktiviteteve të realizuara dhe rezultateve të arritura gjatë vitit raportues.

2. Pasqyrat financiare të FVK-së për vitin 2025 janë përgatitur dhe raportuar në përputhje me standardet dhe kërkesat përkatëse, ndërsa evidencat financiare janë mbajtur në mënyrë të rregullt dhe të kontrollueshme. Kjo dëshmon për qasje të përgjegjshme në menaxhimin e mjeteve financiare, si dhe përkushtim ndaj transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

3. Bazuar në dokumentacionin relevant dhe informacionin e ofruar, Këshilli ka konstatuar se FVK ka arritur të realizojë pjesën më të madhe të objektivave dhe prioritetëve të parapara për vitin 2025. Ky realizim vlerësohet pozitivisht dhe reflekton angazhimin serioz të organeve drejtuese, administratës dhe akterëve tjerë përkatës të Federatës.

4. Këshilli Mbikëqyrës ka vlerësuar gjithashtu se gjatë vitit 2025 FVK ka ruajtur një nivel të lartë të transparencës, integritetit institucional dhe korrektësisë në ushtrimin e veprimtarisë së saj. Menaxhimi i proceseve administrative, sportive dhe financiare është zhvilluar në frymë të përgjegjësisë dhe respektimit të akteve normative në fuqi.

5. Me theks të veçantë, Këshilli Mbikëqyrës e vlerëson si një nga arritjet më të rëndësishme të vitit 2025 organizimin për herë të parë në Kosovë të Kampionatit Evropian U16 në volejboll. Ky organizim paraqet një moment historik për Federatën e Volejbollit të Kosovës dhe për sportin e volejbollit në vend në përgjithësi. Realizimi me sukses i këtij kampionati dëshmon kapacitetin institucional dhe organizativ të FVK-së për të menaxhuar ngjarje të nivelit të lartë ndërkombëtar, duke rritur besueshmërinë e federatës në arenën evropiane dhe ndërkombëtare.

6. Organizimi i Kampionatit Evropian U16 ka pasur ndikim të rëndësishëm në promovimin e Republikës së Kosovës si vend mikpritës i ngjarjeve sportive ndërkombëtare, në avancimin e imazhit të FVK-së, si dhe në krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e volejbollit të gjeneratave të reja. Po ashtu, kjo ngjarje ka kontribuar në fuqizimin e bashkëpunimit institucional me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe në ngritjen e standardeve organizative brenda federatës.

7. Këshilli vlerëson se rezultatet e arritura gjatë vitit 2025, në veçanti organizimi i Kampionatit Evropian U16, përbëjnë bazë të fortë për vazhdimin e zhvillimit strategjik të FVK-së në vitet në vijim, si në aspektin e performancës sportive, ashtu edhe në aspektin e qeverisjes, menaxhimit dhe prezantimit ndërkombëtar.

Në përfundim, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se Federata e Volejbollit e Kosovës gjatë vitit 2025 ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e saj në përputhje me mandatin institucional, duke shënuar progres të dukshëm në funksionimin e përgjithshëm të saj. Të gjeturat dhe konkluzionet e këtij raporti mund të shërbejnë si bazë për raportimin e performancës së FVK-së për vitin 2025 dhe për orientimin e hapave të ardhshëm drejt ngritjes së mëtejshme të efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe impaktit të saj në sportin e volejbollit në Kosovë.

Ne emer të Këshillit Mbikëqyrës

03/03/2026

Burim Rahimaj

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

